

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje filtra, goma dhe bateri automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

34300000-0 Pjesë dhe pajisje për automjetet dhe motorët e tyre

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,548,856** (një milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë **pa TVSH:**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 8**

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse*

*operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”*.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

**a)** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**b)** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në

nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoritetet kontraktore.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi, me qira ose në përdorim.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronësi/qira/perdorim

### **Shënim:**

Për mjetet me status përdorimi qira/hua përdorje të disponohet kontrata noteriale përkatëse mes qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Për këtë mjet duhet të paraqesë librezë qarkullimi, aktin e kolaudimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimin. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objket prokurimi dhe pozicionin gjeografik të autoritetit kontraktor kërkuese.

4. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetorë të thjeshtë	1
<b>Total</b>	<b>2</b>

- Për shoferin të paraqitet kontrata e punës si dhe leja e drejtimit.
- Për punëtorin e thjeshtë të paraqitet kontrata e punës përkatëse.

### **Shenim:**

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE mund të paraqesë edhe 1 punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave, objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 1 punonjësi, përkatësisht shofer/punëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor të thjeshtë, OE paraqet në staf të 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen e drejtimit përkatëse për mjetin dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

5. Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/broshurë/ skede teknike të baterive**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Në katalogë/ broshura/ skede teknike duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST. Katalogët/broshurat/skedat teknike duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emërtimi i mallit	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Kodi i mallit nxjerrë nga	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ ekuivalent
-----	-------------------	------------------------------	----------------------	--------------------------	---------------------------	-----------------------------------------------------

					<b>katalogu</b>	
<b>1</b>						
<b>2</b>						
<b>etj</b>						

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi si dhe i shërben AK në identifikimin sa më të saktë të informacionit teknik dhënë nga OE pjesëmarrës, duke sjellë lehtësi dhe shmangie të konfuzioni në punën e AK për vlerësimin e ofertave.

**6.** Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/broshurë/ skede teknike të **gomave**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Në katalogë/ broshura/ skede teknike duhet te markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt goma dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST. Katalogët/broshurat/skedat teknike duhet të shoqërohen me një listë të gomave sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i mallit</b>	<b>Emërtimi kompanisë prodhuese</b>	<b>Emërtimi i katalogut</b>	<b>Numri i faqes në katalog</b>	<b>Kodi i mallit nxjerrë nga katalogu</b>	<b>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ ekuivalent</b>
<b>1</b>						
<b>2</b>						
<b>etj</b>						

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi si dhe i shërben AK në identifikimin sa më të saktë të informacionit teknik dhënë nga OE pjesëmarrës, duke sjellë lehtësi dhe shmangie të konfuzioni në punën e AK për vlerësimin e ofertave.

**7.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e gomave jo më pak se 40.000 (dyzetë mijë) kilometra per automjetet dhe jo me pak se 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) kilometra per motoçikletat, nga dita e furnizimit. Kontraktori fitues gjatë periudhës së garancisë është i

detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit sic mund të jete difekti në prodhim. Çdo ofertues ofron garanci për gomat sipas tipologjisë së tyre dhe km që do të përshkojnë.

**8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e baterive për jo më pak se 12 muaj nga dita e furnizimit, si dhe marrjen përsipër të zëvendësimit të baterive me defekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët gjatë zbatimit të kontratës, pas marrjes së njoftimit nga AK. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se do ta shoqërojë mallin me çertifikatën e garancisë së baterive në momentin e dorëzimit të tij tek autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit sic mund të jetë difekti në prodhim. Çdo ofertues ofron garanci për bateritë me afat jo më pak se 12 muaj nga dita e furnizimit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga një grup i posaçëm nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**